



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401896/3

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve Kavajë.*

Drejtuar: **Znj. Etleva BISHA**
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Për dijeni: **Z. Ismail KADIU**
Drejtorit të Shtëpisë së të Moshuarve

KAVAJË

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave të njeriut, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 22.10.2014, vijuan inspektimin e radhës në Shtëpinë e të Moshuarve, Kavajë.

Sjellim në vëmendjen tuaj se në vitin 2013 është kryer inspektim në këtë qendër rezidenciale dhe pas problemeve të konstatuara, ju jemi drejtuar me rekomandim për marrjen e masave për:

1. Rikonstrukcionin e godinës së Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë, me qëllim evitimin e lagështirës së madhe të krijuar në të dy katet e godinës.
2. Shtimin në organikë me një psikiatri, një punonjës social dhe roje të objektit.
3. Shtimin e kuotës ushqimore.
4. Vendosjen e një lavatriçeje profesionale dhe të një tharëse rrobash.
5. Shtimin e fondeve, me qëllim pagimin e shpenzimeve të energjisë elektrike, blerjen e medikamenteve, venien në punë të kaldajës etj

Lidhur me qëndrimin ndaj rekomandimeve të sipërcituara, na keni

kthyer përgjigje se me mundësitë që do u krijojë buxheti i vitit 2013, do të ndërhyhet me shtesa të fondeve për këtë institucion në veçanti dhe për të gjithë institucionet e tjera.

Në takimin e bërë me drejtuesin e kësaj qendre, u informuam se nga rekomandimet e sipërcituara, ishin zbatuar pika 3, 4, dhe pjesërisht pika 2. Konkretisht, është shtuar një psikologe, (e komanduar nga Bashkia Kavajë); është rritur kuota ushqimore, nga 280 lekë në 300 lekë në ditë; është vendosur lavatriçe profesionale dhe tharëse rrobash.

Nuk është bërë rikonstruksioni i godinës dhe nuk ka patur shtim fondi për pagimin e shpenzimeve elektrike, etj.

Gjatë këtij inspektimi u vu re një pamje tjetër që në hyrje të ambjenteve të jashtme të godinës. Ishin lyer muret dhe ambjentet ndihmëse në oborr, duke i dhënë kështu mundësinë të moshuarve për të kaluar kohën më këndshëm dhe për t'u relaksuar në ato ambiente.

Edhe në ambjentet e brendshme të godinës dy katëshe, ishin bërë disa rregullime, të ndihmuar nga donacione të ndryshme. Ishin rikonstruktuar tre dhoma. Janë vendosur panele diellore, me ndihmën e një shoqate Irlandeze-Shqiptare, ndërmjetësuar nga Ambasada Zviceriane në Shqipëri. Ishin vendosur kamera sigurie dhe kontrollohej nga një monitor, i vendosur në zyrën e drejtorit të qendrës. Dhomat të pajisura me televizorë. Kishte pesë frigoriferë të ftohjes së ujit. Për të moshuarit e sëmurë që ndosheshin në qendër, ishin sjellë dyshekë specifike. Kjo për faktin se në këtë trajtohen 7 të paralizuar, 7 të verbër dhe 9 me prapambetje mendore.

Nuk duhet të lemë pa theksuar faktin e përkushtimit të lartë në punë nga ana e stafit të kësaj qendre.

Nga inspektimi i kryer u konstatuan edhe problematikat e mëposhtme:

1. Nuk ka sallë fizioterapie për të moshuarit. Në këtë qendër ka të moshuar të sëmurë: 7 të paralizuar, 9 me prapambetje mendore, 7 të verbër, të cilët kanë nevojë për seanca fizioterapie.

2. Mungesa e një ashensori.

3. Nuk funksiononte sistemi qëndror me kaldajë dhe ngrohja realizohej me soba gazi e reflektorë. Kjo për arsye se nuk ka fonde për të përballuar shpenzimet për blerjen e karburantit si dhe të pagesës së energjisë elektrike.

4. Nuk ka roje objekti.

5. Nuk ka shofer. Në këtë qendër kishte një furgon, i cili nuk ishte në gjendje pune. Rregullimi i tij kërkon shpenzime, gjë që është e pamundur të bëhet me fondet e akorduara për këtë institucion. Ky mjet është i nevojshme për transportimin e të moshuarve si për nevoja emergjence, ashtu edhe për aktivitete të ndryshme.

6. Duke qenë se në këtë shtëpi të moshuarish ka një numër të madh përfituesish, aktualisht 46 të moshuar me një kapacitet 65 persona, numri i punonjësve të stafit ishte i pakët për kryerjen sa më cilësore të shërbimeve ditore të tyre, bazuar në standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në qendrat rezidenciale për të moshuarit.

7. Nuk janë bërë trajnime të stafit të qendrës.

Sa më lart, institucioni ynë i është drejtuar me rekomandim Kyetarit të Bashkisë Kavajë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.850 datë 15.12.2006 *“Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave në.60 datë 01.02.2006 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”, për marrjen e masave për:*

1. Rikonstrukcionin e godinës së Shtëpisë së të Moshuarve Kavajë.
2. Rritjen e numrin të stafit me: kujdestarë, punonjës socialë, psikologe, roje objekti, infermier, dy sanitare, mjek me kohë të plotë.
3. Funkcionimin e kaldajës.
4. Ngritjen e një salle fizioterapie
5. Vendosijen e një ashensori.

Por, për t’iu përgjigjur sa më shumë nevojave të përditshme të të moshuarve në këtë qendër dhe për të plotësuar edhe standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale për të moshuarit,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave:

1. Ndryshimin e organikës, duke shtuar numrin e stafit me: kujdestarë, punonjës socialë, psikologe, roje objekti, infermier mashkull, dy sanitare, mjek me kohë të plotë. Për shtimin në strukturë me 3-4 kujdestarë dhe fizioterapistë
2. Për përshkrimin e vendit të punës për çdo punonjës.
3. Për trajnimin e stafit të qendrës.
4. Shtimin e fondeve në zërat “601”, “602”.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se,

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI

